



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

Nr. 2360 Prot.

Tiranë, më 11/10/2023

URDHËR

Nr. 60, datë 11/10/2023

PËR

**HAPJEN E PRANIMEVE NË STUDIMET E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë”, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe në zbatim të shkresës së MAS, Nr. 3060/1 Prot., datë 19.7.2023, lëndë: “Mbi listën e udhëheqësve në programet e studimit të ciklit të tretë në Doktoratë, për vitin akademik 2023-2024”,

URDHËROJ:

Hapjen e pranimeve në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2023-2024, në programet e studimit si më poshtë:

1. Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfisha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfisha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni” - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit,
2. Doktoratë në “Inxhinieri Fizike” - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike,
3. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfisha “Automatizimi i Industrisë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
REKTORI

4. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Energjitiqë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,
5. Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisi” – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,
6. Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedisi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave,
7. Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave.

Aplikimet e kandidatëve për studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës, do të kryhen nga data 13.10.2023 deri më datë 10.11.2023.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Andrea Maliqari

